


DEMOKRACIA PO NDËRTOHET



ROLI I QEVERISË NË ARSIM DHE SHËNDETËSI

RINESA (14), ALBINA (14), SEBAHATE (15), RIDON (14), LEUTRIM (14), LEARD (14)


Qeveria është institucion, roli i së cilës është shumë i rëndësishëm në jetën tonë, sepse Qeveria prek pothuajse çdo sferë të jetës sonë. Sof, do të flasim për rolin e Qeverisë në arsim dhe shëndetësi si dhe ndikimin e saj tek të gjithë ne

Të dashur lexues, në artikullin tonë do të informoheni për rolin që Qeveria si institucion e ka në fushën e arsimit dhe në atë të shëndetësisë. Arsyeja pse i morëm këto dy fusha është, sepse roli apo ndikimi i tyre në jetën tonë si qytetarë, por edhe si nxënës është shumë i madh.

Të flasim pak për Qeverinë si institucion. Qeveria ushtron Pushtetin Ekzekutiv. Pushtet ky i cili ka rëndësi shumë të madhe, sepse po të mos ekzistonte ky pushtet, vendi ynë si vend demokratik nuk do të funksiononte ashtu siç funksionon sot. Në krye të Qeverisë e kemi Kryeministrin i cili bën mbarëvajtjen e tërë punës që Qeveria si institucion e ka. Në kuadër të Qeverisë funksionojnë edhe ministri të ndryshme. Në vazhdim


do të njoftoheni më shumë rreth Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, dhe asaj të Shëndetësisë si dhe rolin që Qeveria e luan mbi këto dy fusha. Puna e Ministrisë së Shëndetësisë është baza e një vendi të zhvilluar, sepse falë saj ne së pari kemi shëndet shumë të mirë. Po ashtu, kemi edhe mjete që nëse shëndeti ynë përkeqësohet, atëherë nuk jemi të obliguar të kërkojmë shërim në vende të tjera. Edhe pse Kosova është një vend në zhvillim, prapëseprapë udhëheqësit tanë mundohen që qytetarëve të vet t'iu ofrojnë kushte sa më të mira për jetesë. Për më shumë, ju ftojme të shikoni edhe vizatimin që shoqja jonë e dashur Albina e ka bërë për Ministrinë e Shëndetësisë.

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË



Këtu kemi paraqitur disa shtretër, në të cilët vendosen qytetarë të cilët kërkojnë shërim në shtëpi të shëndetit. Këta shtretër janë siguruar nga Ministria e Shëndetësisë

Ashtu siç iu njoftuam më lart, tash do të flasim pak për Ministrinë e Arsimit. Kjo ministri, neve si qytetarë të Republikës së Kosovës, na ka ofruar mundësi shumë të mira shkollimi. Po ashtu, ka zbatuar ligje të cilat kanë ndikuar në rritjen e performancës tonë si nxënës. Si shembull, mund të marrim testet e ndryshme të cilat zhvillohen kohë pas kohe, si në ambientet shkollore, po ashtu edhe jashtë saj. Tërë kjo bëhet në mënyrë që ne të kemi cilësi të lartë në arsim. Vlen të theksohet se kjo Ministri ka punuar gjithashtu edhe në sigurimin e librave për nxënësit e shkollave fillore. Kjo pa dyshim që neve si qytetarë na ka lehtësuar punën, duke u nisur nga fakti që ka familje të cilat nuk mund t'ua sigurojnë librat fëmijëve të tyre. Pra, e mira e përbashkët sigurohet falë këtij institucioni, Qeverisë.



Ministria e Arsimit, e punuar nga shoqja Rinesa



Angazhimi i grupit për një artikull sa më të mirë

KUVENDI DHE FUNKSIONET E TIJ

ARJAN (13), EGZON (14), GENTA (14), FJOLLA (14), ALBANA (14), BELINDA (14)

*Funksioni legjislativ

*Funksioni përfaqësues

*Funksioni kontrollues

Lexues të dashur, në këtë artikull do të kuptoni më shumë për rolin që luan Kuvendi në një shtet demokratik

A e dini se çfarë institucioni është Kuvendi? Kuvendi është institucion ligjvënës. Ai propozon, si dhe miraton ose nuk miraton ligjet. Në Kuvendin e Kosovës bëjnë pjesë 120 deputetë. Këta deputetë i përfaqësojnë interesat e popullit. Meqenëse jemi përafërsisht 2 milionë banorë, ne fuqinë tonë ia besojmë deputetëve dhe presim nga ata që të na përfaqësojnë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Në Kuvend diskutohen çështje shumë të rëndësishme për jetën tonë dhe merren vendime që i prekin ato. Janë disa ligje që merren në Kuvend dhe ndikojnë në mënyrë direkte tek ne nxënësit, si për shembull ligjet për arsimin.

Kuvendi po ashtu mundohet që ne nxënësve të na sigurojë mirëqenie sociale. Kjo bëhet duke na ofruar

libra që ne të jemi sa më të ditur dhe ta ndërtojmë sa më shumë të ardhmen tonë. Në mënyrë që të sigurohet e ardhmja e ndritur, shkollimi fillor si dhe i mesëm i ulët është bërë i obligueshëm për të gjithë nxënësit pa dallim feje, gjinie, moshe, race, etj. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka tri funksione kryesore: funksionin përfaqësues, funksionin legjislativ dhe funksionin kontrollues. Po ashtu, Kuvendi zgjedh edhe Presidentin e vendit, i cili ka mandat 5 vjeçar. Ndërsa, deputetët kanë mandat 4 vjeçar. Mirëpo, kanë mundësi vazhdimi edhe për mandat tjetër, nëse populli vendos se ata janë personat e duhur, për ta udhëhequr vendin prapë. Prandaj, populli e ka fuqinë më të madhe në një shtet demokratik. Ne asnjëherë nuk duhet të harrojmë se ligjet e miratuara në Kuvend duhet të zbatohen me përpikmëri. Ne duhet të jemi shembull se si duhet zbatuar ligjet dhe parimet e demokracisë. Me punë dhe përkushtim mund t'ia dalim.

DEMOKRACI

Në demokraci, të gjithë jemi të barabartë



Autorët e artikullit

RËNDËSIA E ZGJEDHJEVE

ERZA (13), ERIS (14), JETMIR (14), SHKURTE (13), FLORJAN (13)

DEMOKRACI



Sot morëm shumë informata rreth procesit zgjedhor dhe rreth rëndësisë së votës

Shpesh, të gjithë ne jemi gjendur në situata të ndryshme dhe na është dashur të bëjmë një zgjedhje. Ne si fëmijë të moshës 13 vjeçare, jemi në mëdyshje në lidhje me profesionin të cilin duam ta kemi dhe ta ushtrojmë në të ardhmen. Një ditë duam të bëhemi arkitektë, mandej ditën tjetër pilot apo mjek. Pra, zgjedhja nganjëherë nuk është e lehtë dhe kërkon shumë përkushtim. Zgjedhja e profesionit është vendim i rëndësishëm për të ardhmen tonë. Prandaj, ne mendojmë shumë kur është fjala për të ardhmen. Ndonjëherë, na duhet të zgjedhim apo të marrim vendim grupor. Për shembull, klasa jonë para pak kohësh është dashur të marrë një vendim, në lidhje me një vend që kishim dëshirë ta vizitonim. Për të rënë dakord për vendin, ne votuam vendin tonë të preferuar. Kështu, zgjedhja ishte e drejtë dhe të gjithë u pajtuam. Nga kjo, besojmë kuptohet se mënyra më e mirë për të marrë vendim

grupor është që të gjithë ta shprehin mendimin e vet lirshëm, përmes votës. E ku ka më mirë se kaq? Ku ka më mirë se ti vetë të zgjedhësh të ardhmen e vendit tënd? Falë demokracisë, të gjithë qytetarët pa dallime kanë të drejtë të jenë pjesë e vendimmarrjes në shtet. Gjatë procesit zgjedhor, të gjithë qytetarët e vendeve demokratike, të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, kanë të drejtë të votojnë. Ky proces është procesi më i rëndësishëm demokratik. Secili qytetar duhet të mendojë mirë para se të bëjë zgjedhjen dhe para se t'ia besoj votën një kandidati të caktuar. Nga zgjedhja e qytetarëve varet suksesi i vendit. Dy llojet e zgjedhjeve në Kosovë janë: zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet komunale. Në zgjedhjet parlamentare, ne i zgjedhim deputetët. Kurse, në zgjedhjet komunale i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse. Sot e kuptuam se vota është e drejta e jonë. Vota jonë është fjala jonë dhe ne në demokraci e themi gjithmonë mendimin tonë, sepse jemi të lirë ta bëjmë atë.



Kandidati për deputet




Gazetarët e përgjegjshëm të artikullit

Mediat janë të pranishme gjatë gjithë kohës në jetën tonë. Kur zgjohemi në mëngjes, kur kthehemi nga puna apo shkolla, kur dalim për të shëtitur, ne gjithmonë duam të dijmë se çfarë po ndodh në vendin tonë. Prandaj, i kemi mediat si burim informacioni. Vazhdoni të lexoni për të kuptuar më shumë


Nëse duam që ta dijmë se kë duhet votuar dhe kush e meriton votën tonë duhet të jemi qytetarë të interesuar. Interesimi përfshin informimin tonë mbi ngjarjet në vend.

E kur jemi te informimi, të gjithë e dijmë se mënyra më e mirë dhe më e shpejtë për t'u informuar janë mediat. Kur themi mediat nënkuptojmë edhe rrjetet sociale. Falë mediave, ne informohemi se çfarë ndodh në vendin tonë, në vendet fqinje, por edhe në tërë

botën. Mediat këtë rol të rëndësishëm nuk e kanë fituar vetëm kohëve të fundit, por e kanë pasur që nga fillimi i funksionimit të tyre. Njeriu si qenie, gjithmonë ka qenë kureshtar të dijë më shumë rreth botës që e rrethon. Prandaj, ka shpikur mjetet që ia lehtësojnë shkëmbimin e informatave. Sidomos kur është fjala për demokracinë, transparenca duhet të jetë në nivel shumë të lartë. Qytetarët kanë nevojë të dijnë më shumë për gjithçka që ndodh në demokraci.



Rëndësia e mediave në të gjitha vendet demokratike është shumë e madhe



Mediat konsiderohen si pushteti i katërt dhe na mbajnë të gjithë neve të informuar



Kjo sepse çdo ngjarje ndikon në jetën e qytetarëve. Prandaj, mediat janë si një dritare që hapen para neve për të na ndriçuar mbi çdo zhvillim të mundshëm. Marim shembull Kuvendin e Kosovës. Nëse nuk do të ishin mediat, si do të kishte mundësi që çdo qytetar të informohej se për çfarë po flitet dhe çfarë vendime po merren gjatë një seance të cakuar plenare? Informimi do të ishte shumë i vështirë, i ngadalshëm dhe jo i saktë. Prandaj, mediat siç po e shihni lexues të dashur, janë të lidhura ngushtë me demokracinë. Ne

jemi të interesuar dhe duhet të dijmë mirë se si t'i përdorim në mënyrë të dobishme mediat apo edhe vetë rrjetet sociale. Ne sot kemi qenë shumë afër punës së mediave dhe tani e kuptojmë punën e tyre më mirë. Kjo pasi që të gjithë ne këtu në „Demos-ti“ ishim gazetarë. Andaj, edhe po i ndajmë të gjitha informatat që i morëm sot, me ju lexues. Faleminderit që e lexuat artikullin tonë. Si pasojë, ato duhet të jenë të pavarura dhe të punojnë lirshëm. Jo më kot thuhet se mediat janë pushteti i katërt në demokraci.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Akrashticë“
Klasa: VIII-1
Vendi: Vushtrri